

Projektbuxheti 2025

Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore



Projektbuxheti 2025

Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore

Nëntor 2024

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Projektbuxheti 2025 – pikat kryesore	6
Aneksi 1	16

Përmbledhje ekzekutive

Buxheti vjetor mbetet instrumenti më i rëndësishëm përmes të cilit Qeveria mund të realizojë shumë nga objektivat e saj ekonomike dhe sociale, duke përfshirë këtu nxitjen e zhvillimit të sektorëve të rinj, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, ndikimin në tregun e punës përmes investimeve në fushën e arsimit dhe më shumë. Projektbuxheti i vitit 2025, i cili tashmë ka kaluar shqyrtimin e parë në Kuvendin e Kosovës, ka një vlerë të planifikuar prej rreth 3.6 miliardë eurosh, që përfaqëson një rritje prej 293 milionë eurosh ose 8.9% më shumë se buxheti i vitit 2024. Megjithatë, suksesi i këtij planifikimi varet nga dinamika e shpenzimeve, veçanërisht në investimet kapitale, të cilat shpesh rezultojnë në nënshpenzim.

Për vitin 2025, rreth 219 milionë euro nga rritja e buxhetit janë të destinuara për shpenzime rrjedhëse, duke përfshirë rritjen e pagave në sektorin publik me 111 milionë euro shtesë dhe mbështetjen për pensione dhe transfere me 93.4 milionë euro shtesë. Megjithatë, mënyra se si planifikohet rritja e pagave, përmes ndryshimit të njësive të koeficientëve dhe jo rritjes së vlerës së koeficientit, mund të shkaktojë pasoja ligjore pasi bie ndesh me Ligjin për Pagat.

Në fushën e punësimit, janë ndarë 25.8 milionë euro për financimin e skemave, përfshirë programin "Superpuna". Investimet kapitale janë rritur për 71 milionë euro. Nga gjithsej buxheti për investime kapitale prej 927.8 milionë euro, 90% e tyre janë investime të bartura nga viti i kaluar. Përkundër rritjes së buxhetit për investime kapitale, numri i projekteve të papërfunduara mbetet i lartë, me 264 projekte që i përkasin periudhës 2008–2019 dhe që kanë një buxhet prej 258 milionë euro në buxhetin e vitit 2025.

Për vitin 2025 vërehet një shpërndarje më e barabartë e investimeve kapitale të reja nga qeveria qendrore drejt komunave si dhe një numër më i madh i komunave përfituese, duke reduktuar diskriminimin politik në baza partiake. Komunitatet e drejtuara nga PDK do të përfitojnë 6.7 milionë euro apo 30.4% të investimeve të reja kapitale, ato të LDK 5.6 milionë euro apo 25.6%, të VV 5 milionë euro apo 22.7%, dhe AAK 3.4 milionë euro apo 15.4%. Gjithashtu, është parashikuar një rritje e ndjeshme e mbështetjes për ndërmarrjet private dhe eksportet, me një buxhet prej 20 milionë eurosh për dy agjencitë për mbështetjen e ndërmarrjeve të sektorit privat dhe eksporteve, kryesisht për investime kapitale dhe subvencione.

Ndërkohë, Ministria e Ekonomisë ka pësuar një rënie prej 11.7 milionë eurosh në buxhet, pavarësisht nevojës për investime në infrastrukturën energjetike dhe programet e efikasitetit të energjisë. Në shëndetësi, buxheti për vitin 2025 është planifikuar në 358.8 milionë euro, një rritje prej 21 milionë eurosh ose 6% krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, kjo përfaqëson vetëm 3.9% të BPV-së, duke e vendosur Kosovën pas vendeve të zhvilluara dhe të dytën me shpenzimet më të ulëta në rajon. Për më tepër, qytetarët vazhdojnë të përballen me shpenzime të larta për shëndetësi, që përbëjnë 30–40% të totalit të shpenzimeve në këtë sektor.

Ministria e Mbrojtjes do të ketë rritje të buxhetit prej rreth 55 milionë eurove, nga 153 milionë euro në vitin 2024 në rreth 208 milionë euro në vitin 2025. E gjithë rritja është buxhetuar për kategorinë e investimeve kapitale, në linja sikurse blerja e artikujve dhe sistemeve të mbrojtjes, ndërtime dhe renovime, blerja e automjeteve dhe kamionëve, dhe më shumë.

Për sektorin e arsimit është paraparë një rritje të buxhetit me 11.1 milionë euro ose 3% më shumë se në vitin 2024, ku përfituesit kryesorë janë komunat me një shtesë prej 9.8 milionë eurosh përmes grantit për arsim dhe Universiteti i Prishtinës me 2.4 milionë euro. Rënie të buxhetit në këtë sektor pritet të ketë vetëm Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për afro 1.2 milionë euro.

Sektori i drejtësisë do të përfitojë gjithashtu një rritje prej 12.2 milionë eurosh, duke e çuar totalin në mbi 114 milionë euro për gjashtë institucionet qendrore, me Ministrinë e Drejtësisë që merr rritjen më të madhe me 10.2 milionë euro (22%), e ndjekur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) me 1.6 milionë euro (10%). Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) do të ketë rritje prej 256 mijë euro (1%), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) me 134 mijë euro (14%), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) me 26 mijë euro më të lartë (5%).

Kurse, buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të ketë rritje prej vetëm 700 mijë euro, nga 89.8 milionë euro në vitin 2024 në 90.5 në vitin 2025. Si dhe, buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit do të ketë rënie prej 1.7 milion euro, nga 88.1 milionë euro në vitin 2024 në 86.4 milionë euro në vitin 2025.

Nga 3.6 miliardë euro sa do të jetë buxheti i Kosovës në vitin 2025, komunat do të menaxhojnë me 788.3 milionë euro ose 22%. Krahasuar me vitin 2024, përqindja e buxhetit për komunat në vitin 2025 do të shënojë rritje për 6.1% ose në vlerë prej 46 milionë euro, që kryesisht pritet të mbulojë koston e rritjes së pagave.

Në anën tjetër, disa komuna, si Prishtina, Gjilani dhe Zubin Potoku, rrezikojnë të kenë të njëjtin buxhet si në vitin 2024 për shkak të mos miratimit në kohë të buxhetit në kuvendet komunale.

Me Projektbuxhetin 2025, shtyhet zbatimi i ligjit të ri për tatimin në pronë për vitin 2026, duke shmangur kështu zbatimin e shkallëve progresive të tatimit në vitin 2025. Kjo shtyerje përmes Ligjit të buxhetit nuk është në harmoni me dispozitat ligjore të ligjit të ndryshuar për tatim në pronë.


Po ashtu, projektbuxheti nuk parashikon fonde rezervë për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara të komunave, të cilat shpesh lidhen me kontrata kolektive të hartuara nga niveli qendror.

Gjithashtu, një mangësi e rëndësishme e projektbuxhetit është mungesa e perspektivës gjinore, një aspekt që mbetet i paadresuar edhe në vitin 2025.

Të hyrat buxhetore në vitin 2025 janë projektuar të jenë 3.3 miliardë euro. Krahasuar me vitin 2024, të hyrat buxhetore pritet të rriten për 277.4 milionë apo 9.2%. Kjo rritje pritet të burojë kryesisht nga një performancë më e mirë e tatimit në të ardhurat personale dhe tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) të mbledhur brenda vendit. Ndërsa, nevoja për financim në vitin 2025 për të mbuluar nivelin e gjithmbarshëm të shpenzimeve është rritur nga 285 milionë euro në vitin 2024 në 300 milionë euro në vitin 2025, pra 15 milionë euro ose 5% më shumë krahasuar me vitin 2024.

Shpenzimet rrjedhëse pritet të rriten për 219 milionë euro ose 9% nga viti 2024 në vitin 2025, ndërsa shpenzimet kapitale parashihet të rriten me 71.1 milionë euro ose 8% nga viti 2024 në vitin 2025.

Figura 1. Struktura e financimit të buxhetit të Kosovës (në miliona euro)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT


Figura 2. Rritja e shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse



Krahasuar me vitet e mëhershme vërehet një planifikim i një rritjeje më proporcionale e këtyre dy kategorive. Konkretisht, shpenzimet kapitale parashihet të rriten për 9%, ndërsa shpenzimet rrjedhëse për 8%.


Tek shpenzimet rrjedhëse, rritja më e madhe reflektohet tek kategoria e pagave dhe mëditjeve. Krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2024, në vitin 2025 shpenzimet për paga dhe shtesa janë planifikuar të rriten për 111.1 milionë euro apo 14%, mallrat dhe shërbimet për rreth 17 milionë euro apo 3%, subvencionet dhe transferet për 93.4 milionë euro apo 9%. Subvencionet dhe transferet vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse (rreth 44%, e që është e ngjashme me vitin e kaluar që ishte 45%). Tek rritja e pagave, ndryshimi i njësive së koeficientëve dhe jo e vlerës monetare të koeficientit, nuk është në harmoni me Ligjin për pagat në sektorin publik. Konkretisht, neni 33 në projektbuxhetin e vitit 2025, nuk është në harmoni me nenin 42 të Ligjit për pagat në sektorin publik, i cili ndalon ndryshimin e njësive së koeficientëve dhe nuk parasheh që ndryshimin e tyre mund ta bëjë Kuvendi përmes ligjit të buxhetit.¹ Për të qenë në harmoni nga aspekti ligjor, kjo rritje e pagave përmes ndryshimit të njësive së koeficientëve të pagave, duhet të ndryshohet dhe plotësohet edhe Ligji i pagave në një proces të ndarë, si forma më adekuate nga aspekti ligjor.

Figura 3. Rritja e shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse 2021-2025



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

Figura 4. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse, 2021-2023




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

¹ Kuvendi i Kosovës. [Ligji nr. 08/I-196 për pagat në sektorin publik](#). Qasur më 11.11.2024.

Mbi 124 milionë euro më shumë për pensione dhe politika sociale, nga to 25.8 milionë euro për subvencionim të pagave përmes skemave të punësimit (sikurse "Superpuna"). Pensionet dhe kompensimet parashihen të rriten për 54 milionë euro (nga 431 në 485 milionë euro) apo 13%, politikat dhe shërbimet sociale pritet të rriten për 51.8 milionë euro (nga 159.7 në 211.5) apo 32%, ndërsa pensionet për kategoritë e luftës pritet të rriten për 18.4 milionë euro (nga 117.4 në 135.8 milionë euro) apo 16%. Rënie parashihet të ketë për Shërbimet e Administratës Qendrore me afro 3.7 milionë euro apo 34%, si dhe për Agjencinë e Punësimit për 3 milionë euro (9%); në kuadër të së cilës parashihen si subvencione për skemat e punësimit, sikurse "Superpuna", rreth 25.8 milionë euro. Ndërsa, rritje do të ketë edhe për Agjencinë e Inspektoratit (Inspektoratin e Punës) me rreth 288 mijë euro.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, tek tregu i punës, sfidat mbeten veçanërisht në aspektin e sigurisë në punë, dialogut social dhe reformimit të skemave të asistencës sociale. Aty rekomandohet një fokus i vazhdueshëm në përmirësimin e kushteve të punës, zgjerimin e shërbimeve sociale dhe forcimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale për të adresuar nevojat e grupeve të cënueshme, duke synuar një zhvillim më gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm social.²


Figura 5. Buxheti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

Rritje e financimit të investimeve kapitale nga buxheti i rregullt. Gjatë këtij viti, mbi 92% apo 852 milionë euro e shpenzimeve kapitale do të mbulohen nga financimi i rregullt i buxhetit ndërsa 8% apo 78 milionë euro nga klauzola e investimeve. Krahasuar me vitin 2024, parashihet një rritje e financimit nga buxheti i rregullt prej 68.1 milionë euro apo 9% dhe nga klauzola e investimeve 4% apo 3 milionë euro. Ngjashëm me vitin e kaluar, as në vitin 2025 nuk pritet të përdoren fondet e likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), si burim financimi.

Figura 6. Financimi i shpenzimeve kapitale, në miliona euro



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

Rreth 94.2 milionë euro investime kapitale të reja, apo 10% e gjithsej investimeve kapitale. Për vitin 2025, janë buxhetuar rreth 927.8 milionë euro për investime kapitale, nga të cilat 833.6 milionë euro apo 90% janë planifikuar për vazhdimin e projekteve të mëhershme dhe rreth 94.2 milionë euro apo 10% janë planifikuar për projekte të reja kapitale. Rreth 75% (699.4 milionë euro) e gjithsej investimeve kapitale janë të buxhetuara për nivelin qendror, ndërsa 25% (230.9 milionë euro) për nivelin lokal. Krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 investimet kapitale janë rritur për 71.1 milionë euro apo 8%.

² Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#). 2024

Nga këto 833.6 milionë euro për projektet e vazhduara, 78% (apo 649.8 milionë euro) janë të alokuara tek niveli qendror dhe 22% (apo 183.8 milionë euro) tek komunat;

Në anën tjetër, rreth 94.2 milionë euro të projekteve të reja, 53% (apo rreth 49.6 milionë euro) janë të alokuara për nivelin qendror dhe pjesa tjetër prej 47% (apo 44.6 milionë euro) për nivelin lokal.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) do të menaxhojë me pjesën më të madhe të buxhetit për investime kapitale.

Në vitin 2025, rreth 270 milionë euro apo 29% e buxhetit vjetor të Kosovës për investime kapitale, do të menaxhohen nga MMPHI. Ndëtimi i rrugëve nacionale, hekurudhave, shpronësimit, e investimi në burime ujore, janë disa nga kategoritë që marrin pjesën më të madhe të buxhetit për kapitale. Ndërkaq, për programe sikurse ai për "Banimin e Përballueshëm" janë ndarë 6.5 milionë euro.

Figura 7. Investimet e reja kapitale krahas atyre të vazhduara


€ 833,598,200 (90%)

Të vazhduara nga viti 2024

€ 94,190,615 (10%)

Të reja për vitin 2025

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës




Shpërndarje më e barabartë e investimeve kapitale të reja të nivelit qendror nëpër komuna, si dhe numër më i madh i komunave përfituese. Krahas buxhetit të tyre vjetor që kanë komunat për të realizuar investime kapitale, investimet e reja kapitale të qeverisë qendrore nëpër komuna janë një nga indikatorët që tregojnë (pa) barazinë e saj në buxhetim karshi komunave. Këtë vit, ndarja e këtyre investimeve nuk tregon për një favorizim të komunave të udhëhequra nga Vetëvendosje (VV), e cila udhëheq edhe me qeverinë qendrore. Bazuar në të dhënat e figurës dhe tabelës së mëposhtme, shpërndarja e investimeve, për dallim nga viti i kaluar është e balancuar mes komunave, pavarësisht se cila parti udhëheq me komunën.

Gjithsej vlera e investimeve të reja kapitale të nivelit qendror për projekte specifike në komuna është **22 milionë euro**, ku komunat e udhëhequra nga PDK marrin pjesën më të madhe të këtij buxheti, pasuar nga LDK, VV dhe AAK.

- Komunat e udhëhequra nga PDK (Kaçaniku, Drenasi, Ferizaji, Prizreni, Vushtrria, Mitrovica e Jugut dhe Skënderaji) marrin gjithsej 6.7 milionë euro apo 30.4% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Këto komuna përbëjnë 22.7% të sipërfaqes së Kosovës dhe 31.5% të popullsisë.
- Komunat e udhëhequra nga LDK (Prishtina, Peja, Lipjani, Fushë Kosova, Dragashi, Istogu dhe Vitia) marrin gjithsej 5.6 milionë euro apo 25.6% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Këto komuna përbëjnë 24.7% të sipërfaqes së Kosovës dhe 33.1% të popullsisë.
- Komunat e udhëhequra nga VV (Podujeva, Shtime, Kamenica, Gjilani dhe Mitrovica e Veriut) marrin gjithsej 5 milionë euro apo 22.7% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Këto komuna përbëjnë 14.5% të sipërfaqes së Kosovës dhe 12.7% të popullsisë.
- Komunat e udhëhequra nga AAK (Gjakova, Deçani, Rahoveci, Suhareka dhe Klina) marrin gjithsej 3.4 milionë euro apo 15.4% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Këto komuna përbëjnë 16.8% të sipërfaqes së Kosovës dhe 14.1% të popullsisë.

Komuna me vlerën më të lartë të investimeve të reja është Podujeva me 2.1 milionë euro, pasuar nga Kaçaniku me 1.8 milion euro dhe Drenasi me 1.65 milionë euro. Këto tri komuna së bashku përbëjnë 25.3% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Megjithatë, kur analizohen investimet për kokë banori, komunat më të vogla si Kaçaniku (PDK), Mitrovica e Veriut (VV) dhe Shtimja (VV) dalin në krye, çka sugjeron se madhësia e komunës nuk është faktori i vetëm përcaktues në shpërndarjen e investimeve të reja kapitale nga niveli qendror. Analizuar për kokë banori, Kaçaniku ka vlerën më të lartë me 65.17 euro, pasuar nga Mitrovica e Veriut me 63.94 euro dhe Shtimja me 52.22 euro.

Figura 8. Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna (gjithsej 22 milionë) për vitin 2025



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, ASK (Censusi 2024)

Tabela 1. Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna në vitin 2025

Komuna	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik	Investimet për kokë banori	Investimet kapitale të nivelit lokal pa investimet e nivelit qendror 2025
Podujevë	2,119,500 €	9.6 %	4.5 %	5.8 %	VV	29.84 €	€9,256,442
Kaçanik	1,808,000 €	8.2 %	1.7 %	1.9 %	PDK	65.17 €	€3,473,583
Drenas	1,650,000 €	7.5 %	3 %	2.5 %	PDK	34.34 €	€6,956,940
Pejë	1,480,000 €	6.7 %	5.2 %	5.5 %	LDK	17.90 €	€13,481,658
Shtime	1,270,000 €	5.8 %	1.5 %	1.2 %	VV	52.22 €	€2,546,294
Prishtinë	1,195,000 €	5.4 %	14.3 %	4.7 %	LDK	5.26 €	€46,350,325
Ferizaj	1,100,000 €	5.0 %	6.9 %	3.2 %	PDK	10.06 €	€12,328,834
Malishevë	1,050,000 €	4.8 %	2.8 %	2.8 %	NISMA	23.93 €	€ 6,063,143
Gjakovë	1,013,000 €	4.6 %	5 %	5.4 %	AAK	12.85 €	€14,742,931
Lipjan	1,010,000 €	4.6 %	3.5 %	3.1 %	LDK	18.37 €	€6,786,819
Prizren	849,000 €	3.9 %	9.3 %	5.5 %	PDK	5.76 €	€23,002,236
Deçan	820,000 €	3.7 %	1.7 %	2.7 %	AAK	29.54 €	€ 3,545,661
Rahovec	800,000 €	3.6 %	2.6 %	2.6 %	AAK	19.15 €	€ 6,075,341
Kamenicë	780,000 €	3.5 %	1.4 %	3.9 %	VV	34.06 €	€2,508,091
Fushë Kosovë	700,000 €	3.2 %	4 %	0.8 %	LDK	10.92 €	€4,352,982
Gjilan	680,000 €	3.1 %	5.2 %	3.6 %	VV	8.20 €	€8,365,443
Vushtrri	560,000 €	2.5 %	3.9 %	3.2 %	PDK	9.11 €	€5,032,147
Dragash	550,000 €	2.5 %	1.8 %	3.9 %	LDK	19.03 €	€4,404,329
Mitrovicë	530,000 €	2.4 %	4.1 %	3 %	PDK	8.19 €	€7,490,347
Istog	500,000 €	2.3 %	2.1 %	4.2 %	LDK	15.12 €	€4,352,982
Suharekë	500,000 €	2.3 %	2.9 %	3.3 %	AAK	10.94 €	€6,305,140
Klinë	250,000 €	1.1 %	1.9 %	2.8 %	AAK	8.18 €	€4,406,621
Skënderaj	200,000 €	0.9 %	2.6 %	3.4 %	PDK	4.92 €	€4,579,591
Viti	200,000 €	0.9 %	2.2 %	2.5 %	LDK	5.63 €	€3,865,579
Mitrovicë e Veriut	150,000 €	0.7 %	0.1 %	0.04 %	VV	63.94 €	€2,311,628
Novobërdë	150,000 €	0.7 %	0.3 %	1.9 %	LS	33.37 €	€460,067
Obiliq	74,475 €	0.3 %	1.4 %	1 %	IQ për Obliqin	3.27 €	€5,448,869
Klllokot	24,386 €	0.1 %	0.2 %	0.2 %	LS	8.00 €	€ 91,365
Gjithsej	22,013,361 €			10,896 km ²			218,585,388 €


Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, ASK (Censusi 2024)

Një numër i madh i investimeve kapitale janë të bartura nga vitet e mëhershme. Efikasiteti në mbylljen e investimeve mbetet i ulët. Nga analizimi i të dhënave të prezantuara në projektbuxhetin e vitit 2025, dallohet se numri i projekteve të bartura nga viti në vit vazhdon të jetë i lartë. Aktualisht, 264 projekte kapitale apo 25.5% e projekteve në nivelin qendror janë projekte që kanë filluar gjatë periudhës 2008–2019, e të cilat nuk kanë përfunduar ende, dhe që në buxhetin e vitit 2025 marrin 258 milionë euro. Tejzgjatja e kohës së realizimit të investimeve kapitale, pamundëson realizimin dhe adresimin e nevojave të tanishme infrastrukturore, avancimin e teknologjisë, dhe më shumë.

Dinamikë e ulët e realizimit të investimeve kapitale. Pavarësisht rëndësisë së madhe të investimeve kapitale në buxhetin vjetor të Kosovës dhe potencialit të tyre për të nxitur ndryshime ekonomike, planifikimi dhe zbatimi i tyre mbetet sfidues. Megjithatë viti 2023 shënoi një përmirësim të lehtë prej 3 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak, realizimi i vetëm 69% të investimeve të planifikuara nga të dy nivelet tregon se ka ende shumë hapësirë për përmirësim në menaxhimin dhe shfrytëzimin e këtyre burimeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit. Ngjashëm në vitin 2024, deri në muajin tetor, është realizuar vetëm 45% e buxhetit të planifikuar për investime kapitale në projektbuxhetin e vitit 2024. Bazuar edhe në raportin vjetor të KE, sfida të vazhdueshme në realizimin e investimeve kapitale mbesin planifikimi dhe zbatimi tyre.³


Fondet e pashfrytëzuara të buxhetit për investime kapitale në Kosovë nga viti 2016 deri në vitin 2023 tregojnë një trend rritës, duke qëndruar kryesisht në mbi 200 milionë euro në vit. Që nga viti 2017, teprica e buxhetit të investimeve kapitale në Kosovë nuk ka qenë asnjëherë nën 160 milionë euro. Viti 2020 doli në pah si periudha me tepricën më të lartë, me mbi 287 milionë euro fonde të pashfrytëzuara. Kjo rritje e konsiderueshme mund të lidhet me sfidat që solli pandemia COVID-19, e cila ka ndikuar në zbatimin e projekteve të parapara kapitale. Periudha pas vitit 2020 karakterizohet nga luhajtje, me një rënie të lehtë në vitin 2021, pasuar nga një rritje në 2022 dhe një rënie tjetër të vogël në 2023, duke reflektuar kështu vlera mjaft të larta të mos shfrytëzimit të fondeve për investime kapitale.

Figura 9. Investimet kapitale nga niveli qendror sipas vitit të fillimit të projektit dhe vlerës në buxhetin e vitit 2025




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës

Figura 10. Trendi i realizimit të investimeve kapitale në Kosovë (për nivelin lokal dhe qendror), 2016–2023¹



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

Figura 11. Fondet e pashfrytëzuara të buxhetit për investime kapitale, 2016–2023⁵



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës

³ Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#), 2024

⁴ Bazuar në projektbuxhetin e viteve përkatëse


Rreth 20 milionë euro buxhet për dy agjencitë për mbështetjen e ndërmarrjeve të sektorit privat dhe eksporteve. Në projektbuxhetin e vitit 2025 është ndarë rreth 20 milioën euro buxhet për dy agjencitë që promovojnë përkrahjen e ndërmarrjeve të sektorit privat dhe eksportit. Njëra nga to, Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve me buxhet prej 1.25 milion euro në vitin 2025, që do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është agjenci e re, e themeluar këtë vit.⁵ Ndërkaq për Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA është ndarë buxhet rreth 18.3 milionë euro, apo për 4 milionë euro buxhet më i lartë se në vitin 2024, ku për dallim nga vitet e kaluara, është rritur më ndjeshëm buxheti për subvencione (+3 milionë euro). Edhe KIESA parashihet të zëvendësohet me një agjenci të re pas miratimit të akteve nënligjore, në atë për Inovacion dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (AIPNK), e themeluar po ashtu këtë vit përmes Ligjit për investime të qendrueshme.⁷

Rreth 11.7 milionë euro më pak buxhet për Ministrinë e Ekonomisë, përkundër nevojës së madhe për investime në infrastrukturën energjetike dhe programet e efijencës së energjisë. Në vitin 2025, buxheti i Ministrisë së Ekonomisë ka rënë në 34.3 milionë euro, nga 46 milionë euro sa ishte në vitin 2024. Rënie prej rreth 7 milionë euro do të ketë për subvencione dhe transfere, si dhe do të ketë gati përgjysmim të investimeve kapitale për këtë ministri. Kjo ndonëse për zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2022–2031 nevojiten investime të mëdha për ndërtim të kapaciteteve të energjisë, ku veçse ka ngecje në arritjen e caqeve të kësaj strategjie.⁸ Në Kosovë ka nevojë të madhe për investime në programe të efijencës së energjisë veçmas në sektorin rezidencial dhe sektorin privat.

Rreth 55 milionë euro më shumë për Ministrinë e Mbrojtjes në vitin 2025, me 113 milionë euro të buxhetuara si investime kapitale sikurse në artikuj dhe sisteme të mbrojtjes. Nga 153.1 milionë euro buxhet sa kishte Ministria e Mbrojtjes në vitin 2024, në vitin 2025 është planifikuar rritje e buxhetit të saj në 207.9 milionë euro apo rreth 55 milionë euro më shumë se në vitin 2024, ku e gjithë rritja është alokuar në investime kapitale. Nga investimet më të mëdha që planifikohet të bëjë kjo ministri në vitin 2025 janë: blerja e artikujve dhe sistemeve të mbrojtjes (77 milionë euro), ndërtime dhe renovime (19.3 milionë euro), blerja e automjeteve dhe kamionëve (11.4 milionë euro), dhe më shumë. Kurse, numri i të puësuarve në këtë ministri, që përfshin dhe ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka mbetur i njëjtë sikurse në vitin 2023.

Në shëndetësi, rreth 21 milionë euro më shumë se në vitin 2024. Buxheti i planifikuar për sektorin e shëndetësisë në vitin 2025 pritet të arrijë në 358.8 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 21 milionë euro ose 6% krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje do të shpërndahet midis institucioneve kryesore shëndetësore, me Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar (ShSKUK) që do të përfitojë rritjen më të madhe në vlerë prej 16.3 milionë euro (9%). Ministria e Shëndetësisë do të ketë një rritje prej 2.8 milionë euro (4%), ndërsa Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (FSSh) do të ketë rritjen më të madhe në përqindje, me 24% apo 2.1 milionë euro shtesë. Megjithatë, granti komunal

Figura 12. Buxheti për shëndetësi, 2024–2025



5 Kuvendi i Kosovës. [Ligji nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme](#). Qasur më 11.11.2024

6 Kalkulimi i diferencës mes buxhetit vjetor dhe realizimit të investimeve kapitale është bërë duke u bazuar në buxhetin e ndarë për investime kapitale sipas ligjeve fillestare të buxhetit dhe raportit të serive fiskale mujore të MFPT.

7 Po aty.

8 Instituti GAP. [Progresi në realizimin e disa objektivave kyçe të Strategjisë së Energjisë 2022–2031](#).

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT


për shëndetësi do të pësojë një ulje të lehtë prej 169 mijë euro. Mirëpo, edhe aktualisht, shpenzimet e qytetarëve për shëndetësi, në nivelin prej rreth 30–40% të shpenzimeve totale në këtë sektor gjatë vitit, mbetin ende të larta dhe në nivelin e viteve të mëhershme.⁹

Analiza e shpenzimeve të planifikuara me projektbuxhetin për vitin 2025 për sektorin e shëndetësisë në Kosovë tregon një situatë të ndryshme në krahasim me vendet e tjera evropiane. Me një investim prej 3.9% të Bruto Produktit Vendor (BPV) në shëndetësi, Kosova mbetet prapa shumicës së vendeve të zhvilluara dhe mbetet e dyta me shpenzimet më ulëta në rajon.¹⁰ Kjo shifër është dukshëm më e ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian prej 7.6%, duke nxjerrë në pah një hendek të konsiderueshëm në financimin e kujdesit shëndetësor.¹¹ Vendet si Franca dhe Republika Çeke, me shpenzime prej 9.1%, Islanda me 8.6%, Kroacia me 7.7%, Greqia me 6%, demonstrojnë një angazhim më të lartë financiar ndaj shëndetësisë. Po ashtu, edhe Rumania, me 4.9%, investon më shumë se Kosova në këtë fushë. Në anën tjetër, Zvicra investon më pak, me vetëm 2.3% të BPV-së të dedikuar për shëndetësinë.

Mbi 11 milionë euro më shumë shumë për institucionet kryesore në sektorin e arsimit. Në Projektbuxhetin 2025, për arsimin parashihet një rritje prej 11.1 milionë euro apo 3% krahasuar me vitin 2024. Nga kjo rritje do të përfitojnë kryesisht komunat përmes grantit për arsim me 9.8 milionë euro shtesë, pasuar nga Universiteti i Prishtinës me 2.4 milionë euro. Rënie të buxhetit në këtë sektor pritet të ketë vetëm Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për afro 1.2 milionë euro.


Përkundër rritjes së buxhetit në arsim, krahasuar me vendet e BE-së, Kosova ende shpenzon ndjeshëm më pak. Në mesatare, vendet e BE-së në vitin 2022 shpenzonin 4.7% të BPV-së në arsim¹², ndërsa me Projektbuxhetin e vitit 2025 shpenzimet në arsim në Kosovë do të jenë rreth 4.1% të BPV-së, rënie kjo me 0.4 pikë përqindje krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2024.

Figura 13. Shpenzimet në shëndetësi (% e BPV-së 2022)



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

Figura 14. Buxheti për arsim, 2024–2025



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

⁹ Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#), 2024


¹⁰ Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#), 2024

¹¹ Eurostat – [General government expenditure by function \(COFOG\)](#). Qasur në 7 nëntor 2024

¹² Eurostat – [General government expenditure by function \(COFOG\)](#). Qasur në 7 nëntor 2024

Bazuar në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2024¹³, Kosova po përpiket të përmirësojë sistemin e saj arsimor, duke u fokusuar në zbatimin e reformave të reja, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe forcimin e arsimit profesional. Ndërsa janë bërë disa hapa pozitivë, si miratimi i ligjeve të reja dhe pilotimi i kurrikulave të reja, sfidat mbeten në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të arsimit dhe në përshtatjen e aftësive profesionale me kërkesat e tregut të punës. Komisioni Evropian thekson nevojën për veprime të mëtjshme, duke përfshirë zbatimin e plotë të strategjive arsimore, përmirësimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe forcimin e qeverisjes së arsimit profesional për të përgatitur më mirë të rinjtë për tregun e punës.

Figura 15. Shpenzimet në arsim (% e BPV-së 2022)




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

Rreth 12.2 milionë euro më shumë për sektorin e drejtësisë. Sipas Projektbuxhetit 2025, buxheti për gjashtë institucionet qendrore, Prokurori i Shtetit/Këshilli Prokurorial i Kosovës (PSH/KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Instituti Gjyqësor i Kosovës/Akademia e Drejtësisë (IGJK/AD), Ministria e Drejtësisë (MD), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsion (AKK) parashihet të jetë mbi 114 milionë euro. Krahasuar me vitin 2024, rritjen më të lartë të buxhetit do ta ketë Ministria e Drejtësisë me afro 10.2 milionë euro apo 22%, si dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës me 1.6 milionë euro apo 10%. Ngjashëm edhe buxheti për KGJK-në do të jetë për rreth 256 mijë euro më i lartë, rritje kjo me 1% krahasuar me vitin 2024, për AKK-në buxheti do të jetë për 134 mijë euro më i lartë (14%), për ANJF rreth 26 mijë euro më i lartë apo 5%, si dhe për IGJK/AD për afro 2 mijë euro më i lartë.

Sipas Komisionit Evropian¹⁴, Kosova ndodhet në një fazë të hershme të përgatitjes për një sistem gjyqësor funksional dhe luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht përparimeve të kufizuara, vendi ka arritur përmirësime në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore dhe ka miratuar ligje të reja për të forcuar institucionet e drejtësisë. Megjithatë, sfidat mbeten në zbatimin e reformave, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë. Rekomandimet e Komisionit Evropian theksojnë nevojën për përmirësime të mëtjshme në llogaridhënie, integritet dhe efikasitet të sistemit të drejtësisë, si dhe forcimin e kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.

Rritje e buxhetit prej vetëm 700 mijë euro për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga 89.8 milionë euro në vitin 2024 në 90.5 në vitin 2025. Si dhe, **më pak buxhet prej 1.7 milion euro për Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sportit,** nga 88.1 milionë euro (2024) në 86.4 milionë euro në vitin 2025.

Figura 16. Buxheti për disa institucione të sundimit të ligjit



Burimi: Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, Ministria e Financave


¹³ Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#). 2024

¹⁴ Komisioni Evropian. [Commission staff working document. Kosovo 2024 Report](#). 2024

Planifikimet buxhetore për komunat në vitin 2025. Nga 3.6 miliardë euro sa do të jetë buxheti i Kosovës në vitin 2025, komunat do të menaxhojnë me 788.3 milionë euro ose 22%. Krahasuar me vitin 2024, përqindja e buxhetit për komunat në vitin 2025 do të shënojë rritje për 6.1% ose në vlerë absolute prej 46 milionë euro, që kryesisht pritet të mbulojë koston e rritjes së pagave.

Në kategorinë e pagave, komunat priten të shpenzojnë 373 milionë euro, një rritje prej 4.06% krahasuar me vitin 2024. Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, komunat planifikojnë të shpenzojnë 132 milionë euro, një rritje prej afro 11% krahasuar me vitin 2024. Në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2025, komunat kanë planifikuar shpenzime në vlerë prej 231 milionë eurosh, një rritje prej 5.6% krahasuar me vitin 2024. Ndërsa, në subvencione, rritja e buxhetit është për afro 16%, përkatësisht, nga 30.5 milionë euro gjatë vitit 2024, në 35.3 milionë euro në vitin 2025.

Figura 17. Gjithsej buxheti i komunave sipas kategorive, 2024 dhe 2025



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Kuvendit të Kosovës, Gazetës Zyrtare, MFPT

Prishtina, Gjlani dhe Zubin Potoku rrezikojnë të mos kenë rritje të buxhetit në vitin 2025. Nëntë komuna, përfshirë Shtimen, Dragashin, Fushë Kosovën, Kllokotin, Obiliqin, Vushtrrinë, Junikun, Mamushën dhe Zveçanin, do të kenë rënie të buxhetit për investime kapitale në vitin 2025. Në anën tjetër, komunat me rritjen më të lartë të buxhetit për investime kapitale, sipas përqindjes janë Parteshi, Novobërda, Ranillugu, Shtërpca dhe Lipjani (shih Aneksin 1). Ndërsa, tri komuna (Prishtina, Gjlani dhe Zubin Potoku) do të mbeten me buxhet për investime kapitale të pandryshuar krahasuar me vitin paraprak. Këto komuna kanë dështuar të miratojnë buxhetin për vitin 2025, që do të garantonte buxhet më të lartë se në vitin paraprak. Sipas dispozitave ligjore, në vitin 2025, në rast se Kuvendi i Kosovës vendos të mos i shqyrtojë dokumentet buxhetore të miratuara më vonë nga këto komuna, këtyre të fundit u alokohet buxheti i njëjtë si në vitin 2024.

Në këtë rast, kjo nënkupton se Prishtinës, për buxhetin e vitit 2025, të cilin e kishte planifikuar në shumën 128 milionë euro sipas kufijve të përcaktuar në qarkoret buxhetore, do t'i mbetet në dispozicion një buxhet prej 122 milionë eurosh. Gjlani, që kishte planifikuar buxhet prej 39 milionë eurove në vitin 2025, do të përfitojë vetëm 37 milionë euro. Ndërkaq, Zubin Potoku do të ketë afro 300 mijë euro më pak buxhet në vitin 2025 si pasojë e mosmiratimit të buxhetit në kohën e paraprak.

Projektbuxheti i vitit 2025 nuk adreson shqetësimet përmbartimore të komunave. Një pjesë e madhe e komunave të Kosovës po përballen me shpenzime milionëshe, të cilat burojnë nga vendimet gjyqësore lidhur me detyrimet e komunave ndaj të punësuarve në sektorin publik. Këto detyrime janë kryesisht si pasojë e kontratës kolektive në fushën e arsimit, si dhe mbulimin e shpenzimeve për shujta, transport dhe licenca. Problematikat e krijuara nga kjo situatë në nivelin lokal kanë shkaktuar raste të tilla si Komuna e Vitisë, e cila nuk ka arritur të mbulojë pagat e mësimitdhënësve, dhe Komuna e Suharekës, ku për shkak të vendimeve përmbartimore, komuna ka pasur bllokime të llogarive bankare. Ndërsa Komuna e Drenasit vetëm gjatë vitit 2024 ka paguar obligime nga kontrata kolektive mbi 3 milionë euro, ndërsa 7 milionë euro është shuma që kjo

komunë ka paguar për këtë arsye në tri vitet e kaluara.¹⁵ Situatë e ngjashme është në pjesën me të madhe të komunave të tjera të vendit. Kërkesat e vazhdueshme të komunave drejtuar nivelit qendror për të gjetur zgjidhje buxhetore për këtë problem nuk janë marrë parasysh në planifikimet e buxhetit për vitin 2025. Si rezultat, të gjitha komunat e Kosovës do të kenë në dispozicion vetëm 427 mijë euro në fondin rezervë për t'iu përgjigjur sfidave të paparashikuara gjatë vitit 2025.

Shtyhet zbatimi i ligjit të ndryshuar për tatim në pronë për vitin 2026. Sipas Ligjit të ndryshuar dhe plotësuar për tatim në pronë, në vitin 2025 do të duhej të fillonte zbatimi i shkallëve progresive të tatimit në pronë në bazë të vlerës totale të pronave të tatim paguesit.¹⁶ Ligji në fjalë, i miratuar në vitin 2023, parashihte masë tranzitore vetëm për vitin 2024 dhe nuk parasheh në ndonjë nen të tij se përmes ligjit të buxhetit mund të ndryshohen afatet apo normat tatimore të caktuara aty. Andaj, neni 35 i projektbuxhetit të vitit 2025 që shtyen afatin e zbatimit të ligjit për tatimin në pronë për vitin 2026, nuk është në harmoni me vet ligjin e tatimit në pronë. Edhe në këtë rast, ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për tatimin në pronë në një proces të ndarë krahas ligjit të buxhetit, do të ishte forma më adekuate ligjore.

Mungesa e perspektivës gjinore në projektbuxhet mbetet një problem i vazhdueshëm. Sikurse edhe në vitet e kaluara, në projektbuxhetin e vitit 2025 nuk përfshihet analizë mbi vlerësimin e ndikimeve të politikave buxhetore në barazinë gjinore, informacion mbi pasqyrën e prioritetëve të qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore apo masat buxhetore që synojnë në promovimin e barazisë gjinore.

¹⁵ Koha.Net. November 4, 2024. [Komunës së Drenasit i merren nga kontrata kolektive mbi 7 milionë euro.](#)

¹⁶ Kuvendi i Kosovës. [Ligji nr. 08/I-224 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/I-005 për tatimin në pronën e paluajtshme](#). Qasur më 11.11.2024.

Aneksi 1


Tabela 2. Buxheti për investime kapitale sipas komunave krahasur mes vitit 2024 dhe planifikimeve për vitin 2025

Komunat	2024 (euro)	2025 (euro)	%
Deçan	3,124,814	3,545,661	+13%
Dragash	4,498,566	4,404,329	-2%
Drenas	6,379,282	6,956,940	+9%
Ferizaj	11,337,196	12,328,834	+8.7%
Fushë Kosovë	4,640,974	4,352,982	-6%
Gjakovë	12,642,608	14,742,931	+16.6%
Gjilan	8,365,443	8,365,443	0%
Istog	4,102,760	4,352,982	+6%
Kaçanik	3,137,761	3,473,583	+10.7%
Kamenicë	2,367,119	2,508,091	+6%
Klinë	4,151,860	4,406,621	+6.1%
Klllokot	97,992	91,365	-7%
Lipjan	5,519,543	6,786,819	+23%
Malishevë	5,831,403	6,063,143	+4%
Mitrovicë e Jugut	6,629,369	7,490,347	+13%
Mitrovicë e Veriut	2,179,356	2,311,628	+6%
Novobërdë	267,376	460,067	+72%
Obiliq	5,727,826	5,448,869	-5%
Pejë	12,261,271	13,481,658	+9.9%
Podujevë	8,981,680	9,564,415	+6%
Prishtinë	46,350,325	46,350,325	0%
Prizren	22,054,855	23,002,236	+4.2%
Rahovec	5,651,132	6,075,341	+7.5%
Shtime	2,893,120	2,546,294	-12%
Skënderaj	4,284,710	4,579,590	+6.8%
Suhareka	6,022,230	6,305,141	+4.6%
Viti	3,562,339	3,865,579	+8.5%
Vushtrri	6,926,738	5,032,147	-27%
Shtërpçë	553,625	715,961	+29%
Graçanicë	2,312,613	2,708,683	+17%
Hani i Elezit	543,006	605,415	+11%
Junik	406,784	391,491	-4%
Leposaviq	2,530,755	2,994,950	+18%
Mamushë	578,821	504,661	-13%
Ranillug	244,743	329,771	+35%
Zubin Potok	811,521	811,521	0%
Zveçan	932,373	823,508	-11%
Partesh	6,658	49,642	+645%
Gjithsej	218,683,063	230,924,179	+5.6%

Burimi: Kategoria e kapitaleve sipas komunave të paraqitura në Projektligjin për Buxhetin e vitit 2025 dhe Ligji i buxhetit për vitin paraprak (2024)



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

